**AKT THEMELIMI**
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"P.M.A. ALBANIA" Sh.p.k.**

**AKT- THEMELIMI**
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"P.M.A. ALBANIA" Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"P.M.A. ALBANIA" Sh.p.k.** dhe me emer tregtare "**P.M.A. ALBANIA**", zoterohet nga ortaku:

1. **P.M.A** Shoqeri aksionere e te drejtes **ITALIANE** e themeluar me **29/12/1989** dhe e rregjistruar ne rregjistrin e ndermarrjeve me 19/02/1996 me adrese ligjore e fiskale **Brugnera (PN) rruga dell'Industria, 2, kod postar 33070**, e identifikuar me ane te kodit fiskal dhe numri ne rregjistrimit ne rregjistrin e ndermarrjeve Nr. **01161250939** dhe NIPT **01161250939.**

Në përputhje me vullnetin e tij te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosi të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **"P.M.A. ALBANIA" Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1**
**FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **"P.M.A. ALBANIA" Sh.p.k.**

**NENI 2**
**BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionoje në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI 3**
**SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Njesia Administraive Vaqarr, Rruga Bregu i Erzenit, Tirane, Shqiperi me numer pronesie 6/16 Zona Kadastrale 3712, Vol. 9 f. 64. Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

## NENI 4
## KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

## NENI 5
## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria "**P.M.A. ALBANIA**" sh.p.k eshte e organizuar ne formen e nje shoqerie qe merret me:

a) Projektimin, ndertimin, asemblimin, montimin dhe tregtimin e komponenteve te pajisjeve mekanike, elektronike dhe elektromekanike;
b) Merr persiper te prodhoje per agjensite me apo pa depozite, per ndermjarret apo shoqeri qe operojne ne sektorin e prodhimit dhe tregtimit te komponenteve, pajisjeve mekanike, elektronike, elektromekanike dhe elektroshtepiake.
c) Me qellim qe te ndjeki dhe realizoje objektin social, ne respekt te te gjitha limiteve dhe konform ligjit, shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, mobiliare dhe imobiliare qe konsiderohen te nevojshme per te arritur objektivin sociale. Ne kete menyre ndermarja mund te marri ne menyre direkte apo indirekte aksione apo pjese ne shoqeri te tjera apo ndermarje italiane apo te huaja qe kane objektiva te njejta apo jane komplemetare per njera-tjeteren. Gjithmone per te realizuar objektin social shoqeria mund te beje operacione leasing apo te japi hua, apo te leje pasuri imobiliare ne Shqiperi si garanci per te tretet, aq here sa keshilli administrativ e mendon si te nevojshme.

## NENI 6
## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 Leke (njeqindmije Leke), i ndare në 1 (nje) pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

**- P.M.A. S.P.A nje kuote te barabarte me 100 %** - 100.000 Lekë (njëqindmijë).

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

**NENI 7**
**AKTET E SHOQERISE**

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

**NENI 8**
**ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator edhe pse nuk eshte ortak. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise **"P.M.A. ALBANIA" Sh.p.k.**, ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijoje edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare, eshte emeruar:
**Giulia Carnieletto,** te ciles i besohen te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem dhe e identifikuar me karte identiteti Nr. **CA54259CT** dhe me kod fiskal me nr**. CRNGLI76M67G888U.**

**NENI 9**
**DISPOZITAT E FUNDIT**

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tirane.
Ky akt themelim është hartuar në 4 (kater) ekzemplare, 2 (dy) ne gjuhen shqipe dhe 2 (dy) ne gjuhen italiane duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane, 29/05/2023**

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**
**"P.M.A. ALBANIA" Sh.p.k.**
**P.M.A. S.P.A**

CARNIELETTO GIULIA



**P.M.A. S.p.A.**
Via dell'Industria, 2
33070 TAMAI DI BRUGNERA (PN)
Cod. Fisc. e Part. IVA 01161250939
Reg. Imp. 01161250939 - REA 47204